



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Prosvete, Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry Of Education, Science, Technology and Innovation



Funded by
the European Union



“Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lart”
“Support to basic and upper secondary education”

Thirrje për aplikim për Ekspertë për rishikim të teksteve shkollore të Gjuhës Shqipe dhe Matematikës

për klasat 1,2,3,4,5,6,7,8, dhe 9

RRETH RISHIKIMIT TË TEKSTEVE SHKOLLORE

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të arsimit të bazuar në cilësi dhe llogaridhënie. Kjo thirrje është pjesë e këtij qëllimi dhe rrugëtimit tonë për cilësi më të rritur të teksteve shkollore.

Rishikimi i teksteve shkollore synon mbledhjen e të dhënave specifike për cilësinë e teksteve shkollore ekzistuese, identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim dhe ofrimin e rekomandimeve për ndërhyrje në tekstet shkollore ekzistuese me qëllim përmirësimin e tyre duke pajisur kështu nxënësit me tekste shkollore më cilësore. Rishikimi do të krijojë standard dhe kapacitete për përmirësimin të vazhdueshëm të teksteve shkollore për vitet në vijim.

Legjislacioni aktual parasheh rishikim dhe përmirësim të vazhdueshëm të teksteve shkollore aktuale. Mungesa e teksteve shkollore të përshtatshme me kurrikulën vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore në arsim. Studimet e deritanishme mbi tekstet shkollore ekzistuese kanë paraqitur mangësi në adresimin e kërkesave të të nxënit; mungesë të relevancës së tekstit shkollor me kurrikulën; mbingarkesë në përmbajtje (me tema, tekst, fakte dhe formula); mungesë e këndvështrimeve në shpjegimin e temave; strukturë joadekuate/ jo konsistencë e përmbajtjes; mospërputhje me nivelin njohës të nxënësve, etj.

Këto mangësi dhe të tjera, duhet të analizohen në mënyrë profesionale për të ofruar evidencë të saktë për cilësinë e teksteve shkollore si dhe duke hapur rrugë për tekste shkollore të përmirësuara.

MASHTI synon të fillojë procesin e rishikimit të cilësisë së teksteve shkollore duke rekrutuar ekspertë kompetent dhe të pavarur për tu bërë pjesë e Ekipeve të Rishikimit të Teksteve Shkollore. Detyra e Ekipeve të Rishikimit përfshinë analizë profesionale të bazuar në metodologji dhe kritere të mirë përcaktuara për rishikim teksteve shkollore për lëndët e Gjuhës Shqipe dhe Matematikë për klasat 1 deri në 9.

Projekti i Bashkimit Evropian “KosEd: Përkrahje për Arsimin Fillor të Mesëm të Ultë” do të ofrojë mbështetje koordinim të procesit dhe në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të Ekipeve të Vlerësimit.

PROFILI DHE KRITERET E PERZGJEDHJES SË EKSPERTËVE

Ekspertët Rishikues të Teksteve për lëndët e Gjuhës Shqipe dhe Matematikë për klasat 1 deri në 9 do të kenë në përbërje ekspertë me profil dhe përgjegjësi si në vijim:

(1) EKSPERT SENIOR: GJUHË SHQIPE, MATEMATIKË

Eksperti senior i përzgjedhur do të punojë nën mbikëqyrjen e MASHTI-të dhe do të marrë mbështetje dhe udhëzime nga projekti KosEd.

Detyrat dhe pritjet specifike:

- Analizon tekstet shkollore të ndara sipas kriterëve të dhëna;
- Merr pjesë në trajnime specifike për rishikimin dhe përmirësimin e teksteve shkollore;
- Bashkëpunon me anëtarët e Ekspertëve të Vlerësimit dhe specialisten për barazi gjinore në mënyrë që të hartohen raporte gjithëpërfshirëse;
- Kontrollon përputhshmërinë e teksteve shkollore të përmirësuara me rekomandimet dhe ofron një raport mbi masën në të cilën janë ndjekur këto rekomandime;
- Ndhmon, këshillon dhe kontribuon në shkrimin e raporteve dhe dokumenteve të tjera profesionale siç kërkohet nga autoriteti kontraktues.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Të ketë gradë shkencore doktor i shkencës në fushën përkatëse (Gjuhë Shqipe, Matematikë);
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, raportimi dhe të punës në grup;
- Njohuri të mira të sistemit arsimor të Kosovës;
- Aftësi të forta analitike;
- Vendosmëri e fortë për të punuar në afat të caktuar;
- Zotërimi i rrjedhshëm gjuhën angleze në të shkruar dhe të folur është përparësi;
- Njohuri kompjuterike.

Përvoja e përgjithshme profesionale:

- Së paku 5 vjet përvojë në fushën përkatëse;
- Përvojë në fushën e kurrikulës dhe teksteve shkollore;
- Aftësi për të dhënë analiza cilësore dhe sasore.

Kërkesat specifike:

- Njohuri të mira të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe të kurrikulës për Gjuhën Shqipe/Matematikë për të gjitha klasat;
- Njohuri të mira për arsimin para-universitar në Republikën e Kosovës.

Kohëzgjatja

- Data e fillimit: Maj 2023, Data e përfundimit: Gusht 2023. Angazhimi është i paraparë për një periudhë pune prej një muaji brenda periudhës së caktuar, me zgjatje të mundshme të kontratës sipas nevojës.

(2) EKSPERT JUNIOR: GJUHË SHQIPE, MATEMATIKË

Eksperti junior i përzgjedhur do të punojë nën mbikëqyrjen e MASHTI-të dhe do të marrë mbështetje dhe udhëzime nga projekti KosEd.

Detyrat dhe pritjet specifike:

- Analizon tekstet shkollore të ndara sipas kriterëve të dhëna;
- Merr pjesë në trajnime specifike për rishikimin dhe përmirësimin e teksteve shkollore;
- Bashkëpunon me anëtarët e Ekipit të Rishikimit në mënyrë që të hartohen raporte gjithëpërfshirëse;
- Kontrollon përputhshmërinë e teksteve shkollore të përmirësuara me rekomandimet dhe ofron një raport mbi masën në të cilën janë ndjekur këto rekomandime;
- Ndhmon, këshillon dhe kontribuon në shkrimin e raporteve dhe dokumenteve të tjera profesionale sipas kërkesave.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- I/E diplomuar për mësimdhënie;
- Mësimdhënës i licencuar i Gjuhës Shqipe dhe/ose i Matematikës;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, raportimi dhe të punës në grup;
- Njohuri të mira të sistemit arsimor të Kosovës;
- Aftësi të forta analitike;
- Vendosmëri e fortë për të punuar në afat të caktuar;
- Të zotëroj rrjedhshëm gjuhën angleze në të shkruar dhe të folur (do të ishte përparësi), përveç gjuhës shqipe;
- Njohuri kompjuterike.

Përvoja e përgjithshme profesionale:

- Minimumi 2 deri në 5 vjet përvojë në mësimdhënien e Gjuhës shqipe/Matematikës ose minimumi 5 vjet përvojë në hulumtime/konsulenca në arsim;
- Përvojë në fushën e kurrikulës dhe teksteve shkollore;
- Aftësi për të dhënë analiza cilësore dhe sasiore.

Kërkesat specifike:

- Njohuri të mira të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe të kurrikulës për Gjuhën Shqipe/Matematikën për nivelin specifik të kërkuar (Fillor/ Mesëm i ulët).

Kohëzgjatja:

- Data e fillimit: Maj 2023, Data e përfundimit: Gusht 2023. Angazhimi është i paraparë për një periudhë pune prej një muaji brenda periudhës së caktuar, me zgjatje të mundshme të kontratës sipas nevojës.

(3) EKSPERT JUNIOR: PEDAGOG/ PSIKOLOG

Eksperti junior i emëruar në këtë detyrë do të punojë nën mbikëqyrjen e MASHTI-të dhe do të marrë mbështetje dhe udhëzime nga projekti KosEd.

Detyrat dhe pritjet specifike:

- Analizon tekstet shkollore të ndara sipas kriterëve të dhëna
- Merr pjesë në trajnime specifike për rishikimin dhe përmirësimin e teksteve shkollore
- Bashkëpunon me anëtarët e Ekipit të Vlerësimit në mënyrë që të hartoj dhe finalizoj raporte gjithëpërfshirëse
- Kontrollon përputhshmërinë e teksteve shkollore të përmirësuara me rekomandimet dhe ofron një raport mbi masën në të cilën janë ndjekur këto rekomandime
- Ndhmon, këshillon dhe kontribuon në shkrimin e raporteve dhe dokumenteve të tjera profesionale sipas kërkesave

Kualifikimet dhe aftësitë:

- I/E diplomuar në Psikologji apo Pedagogji;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, raportimi dhe të punës në grup
- Njohuri të mira të sistemit arsimor të Kosovës
- Aftësi të forta analitike
- Zotërimi i rrjedhshëm gjuhën angleze në të shkruar dhe të folur është përparësi
- Njohuri kompjuterike

Përvoja e përgjithshme profesionale:

- Minimumi 2 deri në 5 vjet përvojë në profesionin e Psikologut/ Pedagogut ose minimumi 5 vjet përvojë në hulumtime/konsulenca në arsim (Pedagogji, Psikologji Shkollore)
- Përvojë në fushën e kurrikulës dhe teksteve shkollore.
- Aftësi për të dhënë analiza cilësore dhe sasiore.

Kërkesat specifike:

- Njohuri të mira të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe të kurrikulës për nivelin specifik (Fillor/ Mesëm i ulët)

Kohëzgjatja:

- Data e fillimit: Maj 2023, Data e përfundimit: Gusht 2023. Angazhimi është i paraparë për një periudhë pune prej një muaji brenda periudhës së caktuar, me zgjatje të mundshme të kontratës sipas nevojës.

(4) EKSPERT JUNIOR: SPECIALISTE PËR BARAZI GJINORE

Eksperti junior i emëruar në këtë detyrë do të punojë nën mbikëqyrjen e MASHTI-të dhe do të marrë mbështetje dhe udhëzime nga projekti KosEd.

Detyrat dhe pritjet specifike:

- Analizon tekstet shkollore të ndara sipas kriterëve të dhëna
- Merr pjesë në trajnime specifike për rishikimin dhe përmirësimin e teksteve shkollore
- Bashkëpunon me anëtarët e Ekipit të Vlerësimit në mënyrë që të hartoj dhe finalizoj raporte gjithëpërfshirëse
- Kontrollon përputhshmërinë e teksteve shkollore të përmirësuara me rekomandimet dhe ofron një raport mbi masën në të cilën janë ndjekur këto rekomandime
- Ndihton, këshillon dhe kontribuon në shkrimin e raporteve dhe dokumenteve të tjera profesionale sipas kërkesave

Kualifikimet dhe aftësitë:

- I/E diplomuar në shkencë sociale ose fusha të ngjashme të studimit
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, raportimi dhe të punës në grup
- Njohuri të mira të çështjeve të barazisë gjinore
- Aftësi të forta analitike
- Zotërimi i rrjedhshëm gjuhën angleze në të shkruar dhe të folur është përparësi
- Njohuri kompjuterike

Përvoja e përgjithshme profesionale:

- Përvojë në hulumtime/konsulencë për barazi gjinore
- Përvojë në fushën e arsimit, kurrikulës dhe teksteve shkollore
- Aftësi për të dhënë analiza cilësore dhe sasiore

Kohëzgjatja:

- Data e fillimit: Maj 2023, Data e përfundimit: Gusht 2023. Angazhimi është i paraparë për një periudhë pune prej një muaji brenda, me zgjatje të mundshme të kontratës sipas nevojës.

PROCEDURAT E APLIKIMIT

Kandidatët e interesuar mund të dërgojnë CV-në e tyre dhe dëshmi për kërkesat specifike të pozitës, jo më larg se më **08 Maj 2023, në ora 16:00**, në **formë elektronike përmes emailit** në avni.rexha@rks-gov.net, duke mbajtur në CC: mihaela_singer@dai.com dhe info@edguard.org. Subjekti i emailit duhet të ketë mbishkrimin: MASHTI: Aplikimi për Ekspert për Rishikim të Teksteve Shkollore.

Ekspertët duhet të jenë të pavarur dhe të lirë ndaj çfarëdo forme të konfliktit të interesit që do të cenonte punët e tij/saj të pavarur. Kandidatët e interesuar për aplikim nuk mund të jenë apo të kenë qenë në cilësi të recensentëve apo autorëve në tekstet shkollore subjekt i këtij rishikimi.